

REPUBLIKA E KOSOVES - REPUBLIKA KOSOVO - REPUBLIC OF KOSOVA KOMUNA E FERIZAJT - OPŠTINA UROŠEVAC - MUNICIPALITY OF FERIZAJ		
DREJTORIA E ADMINISTRATËS DHE PERSONELIT - UPRAVA ADMINISTRACIJE I OSOBLJA		
Dalesë / Izlazne: Date / Dana: 01.10.2025		
Nr. Orgv. Org. red. 01K	Nr. Prot. Br. Prot. 103	Nr. Faqeve. Br. Strana. 16
Ferizaj - Uroševac		



REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVO • REPUBLIC OF KOSOVA
 KOMUNA E FERIZAJT • OPŠTINA UROŠEVAC • MUNICIPALITY OF FERIZAJ

<https://ferizaj.rks-gov.net/>



ZYRA E PROKURIMIT
 KANCELARIJA ZA JAVNE NABAVKE
 PROCUREMENT OFFICE

Tel.: 038 200 46 045
 E-mail: prokurimi.ferizaj@rks-gov.net
 Adresa: Dëshmorët e Kombit p.n

Në bazë të neni 26 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092. Autoriteti Kontraktues harton këtë:

KONTRATË PUBLIKE KORNIZË (Shërbime)

PJESA I-rë E KONTRATËS:

E lidhur në Ferizaj më datën **01.10.2025**, në mes të:

Komuna e Ferizajt, Zyra e Prokurimit (në vazhdim "Autoriteti Kontraktues"), në njërën anë të cilën e përfaqëson, znj. Arbërie Bekteshi – Udhëheqëse e Zyrës së Prokurimit dhe në anën tjetër:

Grupi i Operatorëve Ekonomik: "EUROLINDI" SH.P.K & "Pro & Co Group" SH.P.K & "Er Dim" SH.P.K, me NUI - 810190827 nga Ferizaj, në vazhdim "Ofruesi i Shërbimeve", të cilën e përfaqëson z. Arlind Idrizi, janë pajtuar të lidhin një Kontratë Publike Kornizë për shërbimet e shënuara më poshtë:

Titulli i kontratës publike kornizë: **"Rregullimi i oborreve të shkollave dhe drenazhimi i jashtëm"**.

Me numër të prokurimit: **656-25-7208-2-1-1**

Neni 1
 Lënda

1.1 Lënda e kontratës do të jetë: **"Rregullimi i oborreve të shkollave dhe drenazhimi i jashtëm"** nga ofruesi i shërbimeve sipas specifikacionit të dhënë.

Neni 2

Kushtet e dërgesës

- 2.1 Afati për kryerjen e shërbimeve do të fillojë pas nënshkrimit të kontratës dhe deri më **30.09.2028 (36 muaj)**, duhet të kryhet në tërësi shërbimi.
- 2.2 Vendi i shërbimit do të jetë në Ferizaj.

Neni 3

- 3.1 Çmimet njësi të shërbimeve janë paraqitur në Ofertën Financiare, Lista e Çmimit e paraqitur nga Ofruesi i Shërbimeve.
- 3.2. Vlera e parashikuar e kontratës kornizë është: **1,550,000.00 Euro (Një million e pesëqind e pesëdhjetë mijë euro e zero cent)**.
Vlera totale e kontratës është: **988.94 Euro (Nëntëqind e tetëdhjetë e tetë euro e nëntëdhjetë e katër cent, është çmimi i peshuar me të cilin është bërë vlerësimi i ofertave)**.
Çmimi për njësi është: **4,333.80 Euro (Katër mijë e treqind e tridhjetë e tre euro e tetëdhjetë cent, është çmimi për njësi me të cilin do të realizohet kontrata)**.
- Kontrata lidhet në bazë të nenit 54.15 të Rregullores Nr.002/2024 për Prokurimin Publik, i cili përcakton se çmimi total i poentuar (peshuar) lexohet në hapje publike të ofertave dhe shërben vetëm për qëllim të vlerësimit të ofertave ndërsa kontrata lidhet me çmime për njësi dhe mund të realizohet deri në vlerë të parashikuar.
- 3.3 Çmimet e njërive do të jenë fikse dhe nuk do të nënshtrohen ndryshimeve për porositë e vendosura nën këtë kontratë publike kornizë.
- 3.4 Pagesat do të bëhen në pajtim me Raportin mujor të ekzekutimit të shërbimeve të aprovuar nga Menaxheri i Kontratës i Autoritetit Kontraktues.
- 3.55 Pagesat do të bëhen në përputhje me Kushtet e Përgjithshme dhe/ose të Veçanta të Kontratës.

Neni 4

Rendi i përparësisë së dokumenteve të kontratës

- 4.1 Kontrata përbëhet nga dokumentet në vijim:

- a) Kontrata Publike Kornizë;
- b) Kushtet e Veçanta të Kontratës;
- c) Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
- d) Tenderi i Ofruesit të Shërbimeve, duke përfshirë Specifikimet Teknike;
- e) Oferta financiare (Lista e Çmimeve);
- f) Urdhër blerja;

- 4.2 Dokumentet e ndryshme që e përbëjnë kontratën konsiderohet se shpjegojnë njëra tjetrën dhe në raste të paqartësisë ose divergjencës, ato duhet të lexohen sipas rendit të përparësisë në të cilin janë dhënë më sipër.

Neni 5

Komunikimet

- 5.1 Të gjitha komunikimet me shkrim që kanë të bëjnë me këtë kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues, nga njëra anë dhe Ofruesit të Shërbimeve nga ana tjetër duhet të cekin titullin e kontratës dhe numrin e saj të identifikimit dhe duhet të bëhen me shkrim. Komunikatat duhet të dërgohen me postë, mesazh, telefaks, faks, e-mail ose të dorëzohen personalisht.

5.2 Nëse personi që dërgon komunikatën kërkon vërtetim të pranimi të saj, ai duhet ta thotë këtë në komunikatën e tij. Sa herë që ka afat të fundit për pranimin e komunikatës me shkrim, dërguesi duhet të kërkojë vërtetim të pranimi të komunikatës së tij. Në të gjitha rastet, dërguesi duhet t'i marrë të gjitha masat e nevojshme për të siguruar pranimin e komunikimit të tij.

5.3 Kudo që në kontratë parashikohet dhënia e ndonjë njoftimi, pëlqimi, miratimi, certifikate, ose vendimi, përveç nëse specifikohet ndryshe në njoftimin e tillë, pëlqim, miratim, certifikatë apo vendim do të jetë në formë të shkruar dhe fjalët "njoftoj", "vërtetojë", "miratoj" ose "vendosë" do të shënohen në përputhje me rrethanat. Ndonjë miratim, pajtim, certifikatë ose vendimi i tillë nuk duhet të mbahet apo vonohet pa arsye.

5.4 Kjo kontratë është përgatitur në gjuhën Shqipe në katër origjinale, tri origjinale për Autoritetin Kontraktues dhe një origjinal për Ofruesin e Shërbimeve.

Për Kontraktuesin:

“EUROLINDI” SH.P.K &



“Pro & Co Group” SH.P.K &


“Er Dim” SH.P.K, Komuna e Ferizajt

Për Autoritetin Kontraktues

Komuna e Ferizajt

Zyra e Prokurimit

Emri dhe Mbiemri	z.Arlind Idrizi	Emri dhe Mbiemri	znj.Arbërie Bektashi
Pozita	Drejtor	Pozita	Udhëheqëse e Zyrës së Prokurimit
Nënshkrimi		Nënshkrimi	
Data	01.10.2025	Data	01.10.2025
Vula		Vula	

Emri dhe Mbiemri	z.Agim Aliu
Pozita:	Kryetar i Komunës
Nënshkrimi:	
Data:	01.10.2025
Vula:	

KUSHTET E PËRGJITHSHME

Neni 1 Përkufizimet

1.1 **"Kontratë"** do të thotë marrëveshja e lidhur ndërmjet Autoritetit kontraktues dhe Ofruesit të Shërbimeve, siç është shënuar në formularin e kontratës të nënshkruar nga palët, duke përfshirë të gjitha shtojcat për këtë dhe të gjitha dokumentet e inkorporuar me referencë në të.

1.2 **"Shërbimet"** do të thotë shërbimet që do të ekzekutohen nga ana e Ofruesit të Shërbimeve në pajtim me Specifikimet dhe Përshkrimin e Çmimit të përfshira në Tenderin e Ofruesit të Shërbimeve.

1.3 **"Ofrues i shërbimeve"** është Operatori Ekonomik ose grupi i Operatorëve Ekonomik, i caktuar në formularin e kontratës, që është palë në kontratë dhe i detyruar të kryej detyrat në bazë të marrëveshjes, dhe që për detyrat e kryera do të marrë shumën e rënë dakord në formularin e kontratës.

1.4 **"Personeli"** do të thotë personat e angazhuar nga Ofruesi i Shërbimeve ose nga Nënkontraktuesi si të punësuar dhe të caktuar për kryerjen e shërbimeve ose të ndonjë pjese të tyre.

1.5 **"Çmimi i kontratës"** do të thotë shuma e deklaruar në Marrëveshjen që përfaqëson shumën totale të pagueshme për ofrimin e Shërbimeve.

1.6 **"Nënkontraktuesi"** do të thotë çdo person fizik, privat ose subjekt i qeverisë, ose kombinimi i tyre, duke përfshirë edhe pasardhësit e tij ligjor ose transferimet e lejuara, për të cilin çdo pjesë e Shërbimeve do të sigurohet ose ekzekutimi i ndonjë pjese të Shërbimeve është nënkontraktuar nga Ofruesi i Shërbimeve.

1.7 **"Palë"** nënkupton Autoritetin Kontraktues ose Ofruesin i Shërbimeve, siç mund të jetë rasti, dhe "Palët" nënkupton të dy prej tyre.

1.8 **"Autoriteti Kontraktues"** nënkupton autoritetin që blen Shërbimet, siç specifikohet në Kontratë.

1.9 **"KPK"** nënkupton Kushtet e Përgjithshme të Kontratës.

1.10 **"KVK"** nënkupton Kushtet e Veçanta të Kontratës.

Neni 2 Gjuha dhe ligji i aplikueshëm

2.1 KVK e saktësojnë cili është ligji që i përcakton të gjitha çështjet që nuk janë të mbuluara në kontratë.

2.2 Kontrata dhe të gjitha komunikimet e shkruara ndërmjet palëve hartohen në gjuhën e specifikuar në KVK.

Neni 3 Transferimi

3.1 Transferimi do të jetë valid vetëm nëse ka marrëveshje të shkruar përmes të cilës Ofruesi i Shërbimeve e transferon kontratën e vet ose një pjesë të saj te një palë e tretë.

3.2 Ofruesi i Shërbimeve nuk mundet që, pa miratim paraprak me shkrim nga Autoriteti kontraktues, ta transferojë kontratën ose një pjesë të saj, ose ndonjë përfitim apo interes nga ajo, përveç në këto raste:

a) kur ka ngarkesë për pagesë, në favor të bankierëve të Ofruesit të Shërbimeve, të shumave që duhet të paguhet ose që do të bëhen borxh sipas kontratës; ose

b) në rast të dhënies së të drejtës së Ofruesit të Shërbimeve siguruesve të Ofruesit të Shërbimeve për të kërkuar pagesën nga ndonjë person tjetër i detyruar në rastet kur siguruesit e kanë shkarkuar humbjen ose detyrimin e Ofruesit të Shërbimeve.

3.3 Për qëllimet e nenit 3.2, aprovimi i një transferimi nga Autoriteti kontraktues nuk do ta lirojë Ofruesin e Shërbimeve nga obligimet e veta për pjesën e kontratës që tashmë është realizuar ose për pjesën që nuk është bartur.

3.4 Pranuesit e dispozitave të kontratës duhet të plotësojnë kriteret e përshtatshmërisë që zbatohen për dhënien e kontratës përveç në raste kur transferimi bëhet në bankë apo kompani të sigurimit ose institucion tjetër financiar.

Neni 4 Nën-kontraktimi

4.1 Nënkontrata është valide vetëm nëse ka marrëveshje të shkruar përmes së cilës Ofruesi i Shërbimeve ia beson realizimin e një pjese të kontratës së tij një pale të tretë.

4.2 Elementet e kontratës që do të nënkontraktohen dhe identiteti i nënkontraktuesve i bëhen të ditura Autoritetit kontraktues me rastin e dorëzimit të ofertes. Në rast të ndryshimit të nënkontraktuesve gjatë implementimit të kontratës, Ofruesi i Shërbimeve duhet të njoftoj me shkrim Autoritetin Kontraktues. Autoriteti kontraktues do ta lajmërojë Ofruesin e Shërbimeve për vendimin e vet brenda 30 ditë pune nga marrja e njoftimit, duke i paraqitur arsyet e veta nëse nuk lëshohet autorizimi. Ofruesi i Shërbimeve nuk nënkontraktton pa autorizim me shkrim nga Autoriteti Kontraktues. Te gjithë nënkontraktuesit e propozuar duhet të përmbushin kërkesat e përshtatshme.

4.3 Autoriteti kontraktues nuk njeh lidhje kontraktore ndërmjet vetes dhe nënkontraktuesve, megjithatë mund të siguroj, ku e konsideronë si të nevojshme, pagesat direkte për nënkontraktorët.

4.4 Ofruesi i Shërbimeve është përgjegjës për aktet, gabimet dhe neglizhencën e nënkontraktuesve të vet si dhe të agjentëve ose të punësuarve, në të njëjtën mënyrë si po të ishin akte, gabime ose neglizhencë e Ofruesit të Shërbimeve, agjentëve të tij ose punëtorëve të tij. Aprovimi i nënkontraktimit të ndonjë pjese të kontratës ose aprovimi i nënkontraktuesit nga ana e Autoritetit kontraktues nuk e liron Ofruesin e Shërbimeve nga obligimet e tij sipas kontratës.

Neni 5 Tatimi

5.1 Ofruesi i Shërbimeve është përgjegjës për të gjitha tatimet dhe detyrimet doganore në përputhje me Ligjin e Republikës së Kosovës.

5.2 Të gjitha tatimet dhe detyrimet tjera doganore konsiderohet se janë përfshirë në çmimin e kontraktuar.

5.3 Menaxheri i Projektit do të harmonizojë çmimin e kontraktuar nëse konstaton se ka ngritje të tatimeve dhe detyrimeve doganore brenda datës prej 28 ditësh para dorëzimit të tenderit dhe datës së fundit të vërtetimit të ekzekutimit të shërbimeve.

5.4 Menaxheri i Projektit nuk do të lejojë ndryshimin e çmimit të kontraktuar për shkak të ngritjes së tatimeve dhe/ose ngritjes së detyrimeve doganore në qoftë se kjo ka ndodhur gjatë kohës sa ka qenë në vonesë Ofruesi i Shërbimeve.

Neni 6 Fillimi dhe Ekzekutimi i shërbimeve

6.1 Ofruesi i shërbimit duhet të fillojë shërbimet sa më shpejt që është e arsyeshme e mundur pas marrjes së urdhrat me ekspeditën e duhur dhe pa vonesë.

6.2 Ofruesi i Shërbimeve do të përfundoj aktivitetet veprimtari brenda afatit kohor të specifikuar në Nenin 2 të Formularit të Kontratës. Nëse Ofruesi i Shërbimeve nuk i përfundon aktivitetet në

datën e caktuar, ai do të jetë përgjegjës për të paguar dëmet e likuiduara. Në këtë rast, Data e Përfundimit do të jetë data e përfundimit të të gjitha aktiviteteve.

Neni 7 Zgjatja e periudhës së ekzekutimit

7.1 Ofruesi i shërbimit mund të kërkojë zgjatje të periudhës së ekzekutimit nëse realizimi i kontratës së tij vonohet, ose pritët se do të vonohet, për ndonjërin nga këto arsye:

a) dështimi i Autoritetit Kontraktues për të përmbushur detyrimet e tij sipas kontratës;

b) forcë madhore siç përcaktohet në nenin 8;

7.2 Brenda 15 ditëve me të kuptuar se një vonesë mund të ndodhë, Ofruesi i Shërbimeve do të njoftojë Autoritetin Kontraktues mbi qëllimin e tij që të bëjë një kërkesë për zgjatjen e periudhës së realizimit për të cilën ai konsideron se ka të drejtë dhe, përveçse kur është rënë dakord ndryshe ndërmjet ofruesit të shërbimeve dhe Autoritetit Kontraktues, brenda 30 ditëve nga e njëjta pikë në kohë të sigurojë Autoritetin Kontraktues me hollësi të plotë në mënyrë që të mund të shqyrtohet kërkesa.

7.3 Brenda 30 ditëve nga marrja e hollësive të përmendura në 7.2, Autoriteti Kontraktues me anë të njoftimit me shkrim do t'i lejojë Ofruesit të Shërbimeve zgjatjen e periudhës së ekzekutimit siç mund të arsyetohet, ose në mënyrë prospektive dhe retrospektive, ose të informojë Ofruesin e Shërbimeve që ai nuk ka të drejtë në zgjatje.

Neni 8 Forca Madhore

8.1. Asnjëra palë nuk konsiderohet se ka bërë shkelje të obligimeve të saj sipas kontratës nëse realizimi i obligimeve të tilla parandalohet nga ndonjë ngjarje e shkaktuar nga një forcë *madhore* që shkaktohet pas datës së njoftimit mbi dhënie të kontratës ose kur kontrata hyn në fuqi.

8.2. Termi "forcë madhore" do të thotë veprimet e zotit, goditjet, mbylljet e objektit ose çrregullimet tjera industriale, veprimet e armikut publik, luftërat qofshin të deklaruara ose jo, bllokadat, rebelimet, rastet e dhunës, epidemitë, rrëshqitjet e tokës, tërmetet, shtrëngatat, vetëtimat, vërshimet, erozionet, trazirat civile, eksplozimet dhe ndonjë ngjarje tjetër e ngjashme e paparashikuar që është përtej kontrollit të palëve dhe nuk mund të përballohet as me kujdesin e duhur.

8.3. Pala e ndikuar nga një ngjarje e forcës madhore do të marrë të gjitha masat e arsyeshme për të mënjeluar paaftësinë e një pale të tillë që të përmbushë detyrimet e saj tani e tutje me një vonesë minimale.

8.4. Ofruesi i Shërbimeve nuk do të jetë përgjegjës për dëmet e likuiduara ose ndërprerje nëse vonesa e tij në realizimin ose dështimi për të realizuar obligimet e tij me kontratë është rezultat i një ngjarjeje të forcës madhore. Autoriteti kontraktues nuk do të jetë i detyruar të paguajë interes për pagesat e vonuara, për mosrealizim ose për ndërprerje nëse vonesa e Autoritetit kontraktues ose lloj tjetër i dështimit për të kryer obligimet e tij është rezultat i forcës madhore.

8.5. Nëse ndonjëra palë konsideron se ndonjë rrethanë e forcës madhore ka ndodhur e cila mund të ndikojë në realizimin e obligimeve të saj, menjëherë do ta lajmërojë palën tjetër, duke dhënë të dhëna detaje mbi natyrën, kohëzgjatjen e mundshme dhe efektin që kanë gjasa ta kenë rrethanat. Përveç nëse udhëzohet ndryshe nga Menaxheri i Projektit me shkrim, Ofruesi i Shërbimeve do të vazhdojë t'i realizojë obligimet e tij sipas kontratës përderisa është mjaft praktike, dhe të angazhojë të gjitha mjetet e arsyeshme alternative për të plotësuar ndonjë obligim që ngjarja e forcës madhore të mos e pengojë atë gjatë punës. Ofruesi i Shërbimeve nuk do të zbatojë mjete të tilla alternative përveç nëse udhëzohet ta bëjë këtë nga Menaxheri i Projektit.

Neni 9 Ndërprerja e Kontratës nga Autoriteti Kontraktues

9.1 Autoriteti kontraktues mundet që, pasi t'i japë Ofruesit të Shërbimeve 14 ditë paralajmërim, ta ndërpresë kontratën në ndonjërin nga rastet e mëposhtme:

- (a) Ofruesi i Shërbimeve dështon në përmbushjen brenda një afati të arsyeshëm të paralajmërimit të dhënë nga autoriteti kontraktues që kërkon nga ai të evitojë ndonjë neglizhencë apo dështim për të realizuar obligimet e veta sipas kontratës, dhe të cilat ndikojnë në mënyrë serioze në realizimin e duhur dhe me kohë të shërbimeve;
- (b) Ofruesi i Shërbimeve refuzon ose është neglizhent në realizimin e urdhrave administrative të dhëna nga autoriteti kontraktues;
- (c) Ofruesi i Shërbimeve ia jep dikujt kontratën apo nënkontratën pa autorizim nga Autoriteti kontraktues;
- (d) Ofruesi i Shërbimeve falimenton ose është duke u mbyllur; punët e tij janë duke u administruar nga gjykatat, ka hyrë në marrëveshje me kredituesit, ka pezulluar aktivitetet biznesore, i nënshtrohet procedurave ligjore lidhur me ato çështje, ose është në ndonjë situatë analoge që shkaktohet nga ndonjë procedurë e ngjashme e paraparë në legjislacionin apo në rregulloret nacionale;
- (e) Ofruesi i Shërbimeve është dënuar për një shkelje që ka të bëjë me sjelljen profesionale, përmes një gjykimi që ka fuqinë e *res judicata*;
- (f) Ofruesi i Shërbimeve është shpallur fajtor për sjellje të rëndë të keqe jo profesionale të dëshmuar me çfarëdo mjeti të cilin mund ta vërtetoj Autoriteti kontraktues;
- (g) Ofruesi i Shërbimeve i është nënshtuar një gjykimi që ka forcën e *res judicata* për mashtrim, korrupsion, përfshirje në ndonjë organizatë kriminale;
- (h) të gjitha modifikimet organizative që përfshijnë ndryshime në personalitetin ligjor, natyrën ose kontrollin e Ofruesit të Shërbimeve, përveç nëse këto modifikime regjistrohen në suplementin e kontratës;
- (i) shfaqet ndonjë paaftësi tjetër ligjore që i pengon realizimit të kontratës;
- (j) Ofruesi i Shërbimeve nuk arrin të japë garancinë ose sigurimin e kërkuar, ose nëse personi që e jep garancinë apo sigurimin më të hershëm të kërkuar në kontratën e tanishme nuk është në gjendje t'i plotësojë zotimet e tij.

9.2 Ndërprerja do të bëhet pa paragjykim ndaj të drejtave apo mundësive tjera të Autoritetit kontraktues dhe Ofruesit të Shërbimeve sipas kontratës. Autoriteti kontraktues, pas kësaj mund të nënshkruajë ndonjë kontratë tjetër me një palë të tretë në emër të Ofruesit të Shërbimeve.

9.3 Autoriteti Kontraktues, pas lëshimit të njoftimit të ndërprerjes së kontratës, do ta udhëzojë Ofruesin e Shërbimeve që të ndërmarrë hapa të menjëhershëm për ta përmbyllur ekzekutimin e shërbimeve në mënyrë të shpejtë dhe të rregullt dhe për t'i zvogëluar në minimum shpenzimet.

9.4 Në rast të ndërprerjes, autoriteti kontraktues, sa më shpejt që të jetë e mundur dhe në prani të Ofruesit të Shërbimeve ose të përfaqësuesve të tij ose duke u bërë atyre thirrjen e duhur, do ta përgatisë një raport mbi shërbimet e kryera. Do të përgatitet edhe një deklaratë e parave që duhet t'i paguhen Ofruesit të Shërbimeve dhe parave që i ka borxh Ofruesi i Shërbimeve Autoritetit kontraktues në datën e ndërprerjes së kontratës.

9.5 Autoriteti kontraktues nuk do të jetë i obliguar të bëjë pagesa tjera për Ofruesin e Shërbimeve derisa të jenë përfunduar shërbimet, ndërsa Autoriteti kontraktues do të ketë të drejtë të marrë nga Ofruesi i Shërbimeve koston ekstra, nëse ka, për të siguruar ofruesin e shërbimeve ose do të paguajë shumën që duhet t'i paguhet Ofruesit të Shërbimeve para ndërprerjes së kontratës.

9.6 Nëse Autoriteti kontraktues e ndërpret kontratën, ai do të ketë të drejtë të marrë nga Ofruesi i Shërbimeve humbjet që i janë shkaktuar nën kushtet e kontratës.

Neni 10

Ndërprerja e Kontratës nga Ofruesi i Shërbimeve

10.1 Ofruesi i Shërbimeve, pasi e ka paralajmëruar Autoritetin kontraktues 14 ditë paraprakisht, mund ta ndërpresë kontratën nëse Autoriteti kontraktues;

- a. nuk arrin t'i paguajë Ofruesit të Shërbimeve shumat që duhet të paguhen në ndonjë certifikatë të lëshuar nga personi i autorizuar pas skadimit të afatit të fundit;
- b. vazhdimisht nuk arrin t'i plotësojë obligimet e veta edhe pas rikujtimeve të përsëritura; ose
- c. ose, si rezultat i Forcës Madhore, Ofruesi i Shërbimeve është i paaftë të kryej një pjesë materiale të Shërbimeve për një periudhë prej jo më pak se gjashtëdhjetë (60) ditë.

10.2 Ndërprerja do të bëhet pa paragjykim për ndonjë të drejtë apo autoritet tjetër sipas kontratës së Autoritetit kontraktues dhe Ofruesit të Shërbimeve.

10.3 Në rast të ndërprerjes sipas paragrafit (a) dhe (b) te Seksionit 10.1, Autoriteti kontraktues do ta paguajë Ofruesin e Shërbimeve për humbje ose dëm që mund t'i jetë shkaktuar Ofruesit të Shërbimeve.

Neni 11

Obligimet e Ofruesit të Shërbimeve

11.1 Ofertuesi do të kryejë Shërbimet sipas kontratës me kujdes, efikasitet dhe zell, në përputhje me praktikat më të mira profesionale.

11.2 Ofruesi i Shërbimeve duhet të pajtohet me urdhërat administrative të dhëna nga Autoriteti Kontraktues. Kur Ofruesi i shërbimeve konsideron se kërkesa e një urdhri administrativ shkon përtej fushëveprimit të kontratës, ai, duke iu ekspozuar dënimit për shkelje të kontratës, do ta njoftojë autoritetin kontraktues për këtë duke i paraqitur arsyet e tij brenda 30 ditësh pas pranimit të urdhrit. Ekzekutimi i urdhrit administrativ nuk do të pezullohet për shkak të këtij njoftimi.

11.3 Ofruesi i Shërbimeve duhet t'i respektojë dhe të veprojë sipas të gjitha ligjeve dhe rregulloreve në fuqi në Republikën e Kosovës dhe do të sigurojë që personeli i tij, të afërmit e tyre, dhe punëtorët vendorë të tij gjithashtu t'i respektojnë dhe të veprojnë sipas këtyre ligjeve dhe rregulloreve.

11.4 Ofruesi i Shërbimeve do të trajtojë të gjitha dokumentet dhe informacionet e marra në lidhje me kontratën si private dhe konfidenciale. Ai nuk do të shpëtojë për aq kohë sa të jetë e nevojshme për qëllimet e ekzekutimit të kontratës, të botojë ose të zbulojë ndonjë të dhënë të kontratës, pa pëlqimin paraprak me shkrim të Autoritetit Kontraktues.

11.5 Nëse ofruesi i shërbimit është një konsorcium i dy ose më shumë personave ose korporatave, të gjithë personat ose korporatat e tilla do të jenë së bashku dhe veçmas të detyruar për të përmbushur kushtet e kontratës. Personi i caktuar nga konsorciumi për të vepruar në emër të tij për qëllimet e kësaj kontrate do të ketë autoritetin për të lidhur konsorciumin. Përbërja e grupit nuk do të ndryshohet pa pëlqimin paraprak me shkrim të Autoritetit Kontraktues.

11.6 Ofruesi i Shërbimeve do të punësojnë personelin kyç të identifikuar në tenderin e tij për të kryer funksionet e përcaktuara në tenderin e tij. Për më tepër, gjatë performancës, dhe në bazë të një kërkesë me shkrim dhe të arsyetuar, autoriteti kontraktues mund të kërkojë një zëvendësim nëse vlerëson se një anëtar i stafit është i paefektshëm ose nuk kryejnë detyrat e tij sipas kontratës. Autoriteti Kontraktues do të miratojë çdo zëvendësim të personelit kryesor të propozuar vetëm nëse kualifikimet e tyre përkatëse dhe aftësitë në thelb janë të barabarta ose më të mirë se ato të identifikuar.

Neni 12 Obigimet e Autoritetit Kontraktues

12.1 Autoriteti Kontraktues do të ofrojë ofruesit të shërbimit menjëherë me ndonjë informacion dhe / ose dokumente në dispozicion të saj, të cilat mund të jenë relevante për zbatimin e kontratës. Dokumente të tilla duhet ti kthehen Autoritetit Kontraktues në fund të periudhës së zbatimit të detyrave.

12.2 Autoriteti Kontraktues do të bashkëpunojë sa më shumë të jetë e mundur me ofruesin e shërbimit për të siguruar informacion që ky i fundit mund të kërkojë në mënyrë të arsyeshme për të kryer kontratën.

12.3 Autoriteti Kontraktues do të caktoj “*Menaxherin e Projektit*”, i ceku në KVK, i cili do të jetë përgjegjës për mbikëqyrjen e kryerjes së shërbimeve gjatë gjithë kohës dhe për raportimin e çdo hollësie Autoritetit Kontraktues.

Neni 13 Dëmet e Likuiduara

13.1 Nëse Ofruesi i shërbimeve me përgjegjësinë e tij nuk arrin t’i realizojë ndonjë ose të gjitha shërbimet brenda limiteve kohore të specifikuara në kontratë, Autoriteti kontraktues, pa njoftim zyrtar dhe pa paragjykim ndaj kompensimeve tjera të tij sipas kontratës, do të ketë të drejtë, për secilën ditë që kalon ndërmjet skadimit të periudhës së kontratës dhe datës aktuale të përfundimit, t’i marrë dëmet e likuiduara të barabarta me 0,25% në ditë të vlerës së shërbimeve të pa kryera deri në një maksimum prej 10 % të vlerës totale të porosisë. Autoriteti Kontraktues mund të zbresë dëmet e likuiduara nga pagesat të cilat duhet ti behen Ofruesit të Shërbimeve. Pagesat e dëmeve të likuiduara nuk do të prekin detyrimet e Ofruesit të Shërbimeve.

13.2 Nëse mos-ekzekutimi i ndonjërit shërbimë parandalon përdorimin e zakonshëm të shërbimeve në tërësi, dëmet e likuiduara të parapara në paragrafin 13.1 do të llogariten në bazë të vlerës totale të porosisë.

13.3 Nëse Autoriteti kontraktues ka fituar të drejtën të kërkojë së paku 10 % të vlerës së porosisë ai mundet, pasi ta njoftojë me shkrim Ofruesin e Shërbimeve të:

a. Ne rast se Autoriteti Kontraktues ka prokuruar vetem në emer të vete Autoritetit, me një operatore ekonomik:

- konfiskojë garancinë e performancës;
- të ndërpresë kontratën, dhe në këtë rast Ofruesi i Shërbimeve nuk do të ketë të drejtë për kompensim; dhe
- të hyjë në një kontratë me një palë të tretë për dhënien e pjesës së mbetur të shërbimeve. Ofruesi i shërbimeve nuk do të paguhet për këtë pjesë të kontratës. Ofruesi i Shërbimeve gjithashtu do të jetë i detyruar të paguajë koston plotësuese dhe dëmet e shkaktuara nga kjo pamundësi e tij.

b. Ne rast se Autoriteti Kontraktues ka prokuruar vetem në emer të vete Autoritetit, me disa operatore ekonomik:

- të konfiskojë garancinë e realizimit;
- të ndërpresë porosinë, dhe në këtë rast Ofruesi i Shërbimeve nuk do të ketë të drejtë për kompensim. Ofruesi i Shërbimeve gjithashtu do të jetë i detyruar të paguajë koston plotësuese dhe dëmet e shkaktuara nga kjo pamundësi e tij; dhe
- të ri-hap konkurrencën me pjesën e mbetur të Operatorëve Ekonomik të kontratës publike kornizë.

c. Ne rast se Autoriteti Kontraktues ka prokuruar ne emer te disa Autoriteteve tjera Kontraktuese, me nje operatore ekonomik:

- Autoriteti Kontraktues i cili ka bere porosine anulon porosine dhe ritenderon, dhe në këtë rast Ofruesi i Shërbimeve nuk do të ketë të drejtë për kompensim. Ofruesi i Shërbimeve gjithashtu do të jetë i detyruar të paguajë koston plotësuese dhe dëmet e shkaktuara nga kjo pamundësi e tij; dhe
- te njoftoj Autoritetin Kontraktues i cili ka udhëhequr prokurimin për sjellje të keqe të Operatorit Ekonomik dhe kërkon nga Autoriteti Kontraktues i përmendur qe të konfiskoj një pjesë proporcionale, ekuivalente me 10% te porosise se leshuar, të garancisë së performancës dhe dërgon shumën tek Autoriteti Kontraktues.

a. Ne rast se Autoriteti Kontraktues ka prokuruar ne emer te disa Autoriteteve tjera Kontraktuese, me disa operatore ekonomik:

- te njoftoj Autoritetin Kontraktues i cili ka udhëhequr prokurimin për sjellje të keqe të Operatorit Ekonomik dhe kërkon nga nga Autoriteti Kontraktues i përmendur qe të konfiskoj një pjesë proporcionale, ekuivalente me 10% te porosise se leshuar, të garancisë së performancës dhe dërgon shumën tek Autoriteti Kontraktues;
- te ndërpresë porosine, dhe në këtë rast Ofruesi i shërbimeve nuk do të ketë të drejtë për kompensim. Ofruesi i Shërbimeve gjithashtu do të jetë i detyruar të paguajë koston plotësuese dhe dëmet e shkaktuara nga kjo pamundësi e tij; dhe
- te ri-hap konkurrencën me pjesën e mbetur të Operatorëve Ekonomik të kontratës publike kornizë.

Neni 14 Siguria e Ekzekutimit

14.1 Ofruesi i shërbimeve do të, jo më vonë se dita e nënshkrimit të kontratës, furnizoj Autoritetin Kontraktues me siguri për ekzekutim të plotë dhe të mire të kontratës. Shuma e sigurisë do të saktësohet në KVK. Siguria e ekzekutimit do të ndalet nga pagesa e Autoritetit kontraktues për çfarëdo humbjeje që është pasojë e mosekzekutimit të plotë dhe të duhur të obligimeve kontraktore nga ana e Ofruesit të Shërbimeve.

14.2 Garancioni do të vazhdojë të mbetet i vlefshëm 30 ditë pas lëshimit të Çertifikatës së Përfundimit.

14.3 Garanconi i ekzekutimit të kontratës do të jetë në formatin e dhënë në Pjesën IV të kësaj kontrate.

Neni 15 Sigurimi që do të merret nga Ofruesi i Shërbimit

15.1 Ofruesi i Shërbimeve do të marr dhe do të ruaj, dhe do të shkatoj Nënkontraktorët të marrin dhe ruajnë, me shpenzimet e tyre, por në bazë të kushteve të miratuara nga Autoriteti Kontraktues, sigurimin nga rreziqet, dhe për mbulim, siç do të specifikohet në KVK.

15.2 Ofruesi i Shërbimeve, me kërkesë të Autoritetit Kontraktues, do të ofroj dëshmi për Autoritetin Kontraktues që sigurimi i tillë është marrë dhe ruajtur dhe se primet e tanishme janë paguar.

Neni 16

Parimet të përgjithshme të pagesave

16.1 Pagesat do të bëhen në Euro. Pagesat që duhet të bëhen sipas faturës së lëshuar nga Ofruesi i Shërbimeve do të bëhen në llogarinë bankare të dhënë në Pjesën V, **Identifikimi Financiar**, i kësaj kontrate që e plotëson Ofruesi i Shërbimeve. I njëjti formular, që i bashkëngjitet kërkesës për pagesë, duhet të përdoret për t'i raportuar ndryshimet në llogarinë bankare.

16.2 Shumat duhet të paguhen brenda jo më shumë se 30 ditësh kalendarike nga data në të cilën kërkesa e pranueshme për pagesë është regjistruar nga departamenti përkatës. Data e pagesës do të jetë data në të cilën debitohet llogaria e institucionit. Kërkesa për pagesë nuk do të jetë e pranueshme nëse nuk plotësohen një ose më shumë nga kërkesat thelbësore.

16.3 Periudha prej 30-ditësh mund të pezullohet duke e lajmëruar ofruesin e Shërbimeve që kërkesa për pagesë nuk mund të plotësohet sepse shuma nuk do të paguhet për shkak se nuk janë dorëzuar dokumentet e duhura përmbajtjesore ose sepse ka dëshmi që shpenzimi mund të mos jetë legjitim. Në rastin e fundit mund të bëhet një inspektim i menjëhershëm për qëllim të kontrollimeve tjera. Ofruesi i Shërbimeve do të japë sqarime, modifikime apo informata të tjera brenda 15 ditësh pas kërkesës. Periudha e pagesës do të llogaritet nga data në të cilën është regjistruar kërkesa për pagesë e përgatitur në mënyrën e duhur.

16.4 Pasi që të ketë kaluar afati i fundit i dhënë në Nenin 16.2, Ofruesi i Shërbimeve mundet që, brenda dy muajsh pas pagesës së vonuar, të kërkojë interesin për pagesë të vonuar me normë të re-zbritje që zbatohet nga Banka Qendrore e Kosovës në ditën e parë të muajit në të cilin ka skaduar afati i fundit, plus shtatë pikë të përqindjes. Interesi për pagesë të vonuar do të zbatohet për kohën që kalon ndërmjet datës së afatit të fundit të pagesës (nuk përfshihet) dhe datës në të cilën debitohet llogaria e Autoritetit kontraktues (përfshihet).

16.5 Të gjitha mos pagesat pas 90 ditësh nga skadimi i periudhës së dhënë në Nenin 16.2 do t'i japin të drejtë Ofruesit të Shërbimeve që, ose të mos e realizojë kontratën, ose ta ndërpresë atë, me paralajmërim prej 30 ditësh për Autoritetin kontraktues.

16.6 Në rast se Autoriteti kontraktues kryen blerje në emër të autoriteteve të tjera kontraktuese, dhe një autoriteti kontraktues nuk i përmbush detyrimet e tij sipas kësaj kontrate, veçanërisht obligimet e Nenit 16.2 ofruesi i shërbimeve mund të informojë AQP-ne për shkelje të tilla. AQP-ja mund të ndalojë autoritetin kontraktues nga përdorimi i çdo dhe të gjitha kontratat qendrore publike kornizë të nxjerra nga AQP.

Neni 17

Kualiteti i Kontrollit

17.1 Parimi dhe modalitetet e Inspektimit të Shërbimeve nga Autoriteti kontraktues do të jenë si në KVK. Autoriteti kontraktues do të kontrollojë punën e ofruesit të shërbimeve dhe të njoftojë atë për çdo defekt që është gjetur. Kontrolli i tillë nuk do të ndikojë në përgjegjësitë e ofruesit të shërbimeve. Autoriteti Kontraktues mund të udhëzojë ofruesit e shërbimeve të kërkojnë një defekt dhe të zbulojnë dhe provojnë çdo shërbim që Autoriteti Kontraktues konsideron se mund të ketë një defekt. Periudha garantuese e defekteve është siç është definuar në KVK.

Neni 18

Përmirësimi i Defekteve

18.1 Autoriteti kontraktues do të njoftojë ofruesit e shërbimeve për çdo Defekt para përfundimit të kontratës. Periudha garantuese e defekteve do të zgjatet për aq kohë sa Defektet të korrigjohet.

18.2 Sa herë njoftimi për një defekt është dhënë, ofruesi i shërbimeve duhet të përmirësoj defektin e njoftuar brenda kohës së specifikuar në njoftimin e Autoritetit Kontraktues

18.3 Nëse ofruesi i shërbimeve nuk e ka korrigjuar defektin brenda kohës së specifikuar në njoftimin e Autoritetit Kontraktues, Autoriteti Kontraktues do të vlerësojë koston e korrigjimit të defektit, ofruesi i shërbimeve do të paguaj këtë shumë, dhe do pasoj një dënim për mungesë Ekzekutimi që llogaritet siç përshkruhet në nenin 13.1.

Neni 19 Konsekuencat e Shkeljes se kontratës

19.1 Pala ka shkelë kontratën nëse nuk arrin të shlyejë ndonjë nga obligimet e veta me kontratë siç është cekur ne Nenin 9 dhe 10.

19.2 Në rastet kur ndodh një shkelje e kontratës, pala e dëmtuar do të ketë të drejtë për këto kompensime:

- a) dëmet; dhe/apo
- b) ndërprerje të kontratës.

19.3 Përveç masave të sipërpërmendura, mund të jepen dëmshpërblime. Ato mund të jenë:

- a) dëme të përgjithshme; ose
- b) dëme të likuidueshme.

19.4 Mbulimi i dëmeve, pagesat apo shpenzimet që rezultojnë nga zbatimi i masave të parapara në këtë nen do të zbatohen duke u zbritur nga shumat që duhet t'i paguhet Ofruesit të Shërbimeve, nga depozita, ose me pagesë nga siguria.

Neni 20 Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjeve

20.1 Palët duhet t'i bëjnë të gjitha përpjekje për të zgjidhur në mënyrë miqësore të gjitha mosmarrëveshjet që mund të ndodhin ndërmjet tyre. Sapo të shfaqet ndonjë mosmarrëveshje, palët do ta lajmërojnë njëra tjetrën me shkrim për qëndrimet e tyre në mosmarrëveshje dhe për ndonjë zgjidhje që ata konsiderojnë se është e mundshme. Nëse cilado palë e sheh të dobishme, palët do të takohen dhe të mundohen ta zgjidhin mosmarrëveshjen. Pala do të i përgjigjet kërkesës për zgjidhje miqësore brenda 15 ditësh pas kërkesës. Periudha maksimale që jepet për arritjen e kësaj zgjidhjeje do të jetë 30 ditë nga fillimi i procedurës. Nëse përpjekja për të arritur zgjidhje miqësore dështon ose nëse pala dështon të përgjigjet me kohë ndaj kërkesave për zgjidhje, të dyja palët do të jenë të lira të vazhdojnë në fazën e ardhshme të procedurës së zgjidhjes së mosmarrëveshjes duke e lajmëruar tjetrën.

20.2 Nëse procedura e zgjidhjes miqësore të mosmarrëveshjes dështon, palët mund të merren vesh të përpiqen të pajtohen përmes institucionit të specifikuar në KVK. Nëse nuk mund të arrihet zgjidhja brenda 30 ditësh pas fillimit të procedurës së pajtimit, secila palë do të ketë të drejtë të vazhdojë në fazën e ardhshme të procedurës së zgjidhjes së mosmarrëveshjes.

Neni 21 Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore

21.1 Nëse nuk mund të arrihet zgjidhje brenda 30 ditësh nga fillimi i procedurës miqësore për zgjidhje të mosmarrëveshjes, secila palë mund të kërkojë:

- a) vendim nga gjyqi; ose
- b) kurdo që palët pajtohen, vendim arbitrimi në pajtim me KVK.

21.2 Para nënshkrimit të kontratës palët duhet të vendosin për mënyrën e zgjidhjes së mosmarrëveshjes, gjykata apo arbitrimi.

Neni 22 Dëmshpërblimi

22.1 Ofruesi i shërbimeve do të mbroje dhe do të dëmshpërblej Autoritetin Kontraktues, zyrtaret

e tij dhe ish zyrtaret, drejtoret, punonjësit dhe agjentet e tij dhe do te jete përgjegjës për te gjitha shpenzimet, humbjet, demet, dhe pagesat e shkaktuara nga Autoriteti Kontraktues, duke përfshire por jo kufizuar shpenzimet e tarifës se avokateve dhe shpenzimet ne lidhje me: neglizhencën ose keqpërdorimet e qëllimshme nga ana e ofruesit të shërbimeve, shkeljet apo shkeljet e pretenduar nga prezantimet e Ofruesit te Shërbimeve, pretendimet nga një palë e tretë se sigurimi i atyre shërbimeve nga ofruesi i shërbimit apo shfrytëzimi i tyre nga apo në emër të Autoritetit Kontraktues apo përdorimi ose sigurimi i ndonjë aseti të siguruar nga Ofruesi i Shërbimeve në lidhje me kryerjen e shërbimeve shkel të drejtat e pronësisë intelektuale të asaj pale të tretë.

PJESA III-të E KONTRATËS
KUSHTET E VEQANTA

KVK në vijim do të plotësojnë dhe/ose ndryshojnë KPK. Sa herë që ka një konflikt, dispozitat këtu do të mbizotërojnë mbi ato të KPK.

Kushtet e Përgjithshme të Kontratës		Amandamentimet/Modifikimi i Nenit përkatës në KPK
Përshkrimi i nenit	Nr. Nenit	Në bazë të LPP-së Ligji me nr. 04/L-042 neni 26 pika 1
Ligji i zbatueshëm dhe gjuha	2.1	Ligjet e Kosovës që janë në fuqi do të zbatohen për të gjitha çështjet që nuk mbulohen nga dispozitat e kontratës. Juridiksioni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë.
	2.2	Gjuha e përdorur do të jetë Gjuha Shqipe
Obligimet e Autoritetit Kontraktues	12.3	Menaxheri i Projektit është: z.Bashkim Bytyçi – zyrtar i lartë për arsimin e mesëm të ulët. Mbikqyres i drejtperdrejt i Menaxherit të Projektit është: znj.Mukadeze Sylejmani – zyrtare financiare në drejtorinë e Arsimit.
Siguria e ekzekutimit	14.1	Kryesi i shërbimit, jo më vonë se dita e nënshkrimit të kontratës, do të dorëzoj tek Zyra e Prokurimit një sigurim për ekzekutim të plotë dhe të mirë të kontratës. Shuma e sigurisë së ekzekutimit është 10% e vlerës së parashikuar të kontratës në shumë prej: 155,000.00 € (Njëqind e pesëdhjetë e pesë mijë euro e zero cent) , valide nga një bankë e licencuar ose kompani e licencuar nga BQK-ja. Ky sigurim është valid 37 muaj.
Sigurimi që do të merret nga ofruesi i shërbimit	15.1	Rreziqet dhe mbulesat nga sigurimi do të jenë: a) Mjetet motorike të palës së tretë, b) Përgjegjësia e palës së tretë, c) Përgjegjësia e punëdhënësit dhe kompensimi i punonjësve, d) Përgjegjësia profesionale, Humbje ose dëmtim të pronës dhe pajisjeve.
Pagesa	16	Pagesa do të bëhet nga Drejtoria e Arsimit , pas përfundimit të çdo shërbimi, kryesi i shërbimit duhet të dorëzoj tek AK një faturë origjinale dhe nga një kopje fletëdërgesës –

		fletëpranimi për shërbimet e kryera. Të gjitha faturat e dorëzuara duhet të deklarohen në Euro. Çdo faturë duhet të përmbajë informacionet e nevojshme. Pagesa do të bëhet sipas shërbimeve nga OE, situacioni i nënshkruar nga Organi Mbikqyrës.
Kualiteti i Kontrollit	17.1	Parimi dhe modalitetet e inspektimit të shërbimeve nga Autoriteti Kontraktues janë si më poshtë: Menaxheri i projektit do të kontrolloj çdo detaj të projekti.
Vërejtje		Në rast të mos përmbushjes së Kontratës nga Operatori Ekonomik, në bazë të Kushteve të Përgjithshme dhe Kushteve të Veçanta të Kontratës, Autoriteti Kontraktues do të ndërmarr të gjitha masat e parapara me Ligjin dhe Legjislacionin Dytësor të Prokurimit Publik duke konfiskuar Sigurimin e Ekzekutimit dhe shkëputjen e njëanshme të Kontratës. Me vërejtjen numër rendor 3 si dhe rekomandimin nga Menaxheri i kontratës Autoriteti Kontraktues do të konfiskoj sigurimin e ekzekutimit dhe shkëputjen e njëanshme të kontratës.
Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjes	20.2	Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit së kësaj kontrate dhe se është e mundur të zgjidhet në mënyrë miqësore, përgjegjës për zgjidhjen e tyre do të jenë personat përgjegjës të Autoritetit Kontraktues – Komuna e Ferizajt.
Zgjidhja e mosmarrëveshjes me procedure gjyqësore	21.1	a) Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit së kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet në Gjykatën Komerciale në Prishtinë, në pajtim me ligjet në Kosovë.

Nr	Përshkrimi	Çmimi i peshuar	Pesha	Çmimi i peshuar	Vlera monetare se sa duhet te shpenzohet secila kategori
A	Totali 1	€ 931.00	75%	€ 698.25	1,162,500.00 €
B	Totali 2	€ 237.80	5%	€ 11.89	77,500.00 €
C	Totali 3	€ 397.00	5%	€ 19.85	77,500.00 €
D	Totali 4	€ 357.00	5%	€ 17.85	77,500.00 €
E	Totali 5	€ 2,411.00	10%	€ 241.10	155,000.00 €
	TOTALI	4333.8	100%	988.94	1,550,000.00 €



REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVA • REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E FERIZAJT • OPŠTINA UROŠEVAC • MUNICIPALITY OF FERIZAJ

<http://kk.rks-gov.net/ferizaj>



ZYRA E PROKURIMIT
KANCELARIJA ZA JAVNE NABAVKE
PROCUREMENT OFFICE

Tel.: 038.200.46.045
E- mail: prokurimi.ferizaj@rks-gov.net
Adresa: Dëshmorët e Kombit p.n.

01. Nr. 287/2025

Datë: 01.10.2025

Në bazë të nenit 81 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Lgjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092, si dhe nenit 70 të Rregullores Nr. 002/2024 për Prokurimin Publik, e datës 11.11.2024, Kryetari i Komunës merr:

V E N D I M

PËR EMËRIMIN E MENAXHERIT TË KONTRATËS DHE MBIKQYRËSIT TË DREJTPËRDREJTË TË MENAXHERIT TË KONTRATËS

- Emërohet Menaxheri i kontratës dhe Mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë i Kontratës për kontratën: “Rregullimi i oborreve të shkollave dhe drenazhimi i jashtëm”, me numër të prokurimit: 656-25-7208-2-1-1
- Emërohet Menaxher i kontratës: z.Bashkim Bytyçi – zyrtar i lartë për arsimin e mesëm të ulët.
- Emërohet Mbikëqyrës i drejtpërdrejtë i Menaxherit të Kontratës: znj.Mukadeze Sylejmani – zyrtare financiare ne drejtorinë e Arsimit.
- Menaxheri i kontratës, dhe Mbikëqyrës i drejtpërdrejtë i Menaxherit të Kontratës obligohen që të bëjnë administrimin dhe menaxhimin e implementimit të kontratave në pajtim me Rregulloren Nr. 002/2024 për Prokurimin Publik, e datës 11.11.2024, për Prokurimin Publik, si dhe Manualin për Përdorim të Modullit për Menaxhim të Kontratës;
- Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.
I'u dorëzohet:
 - Menaxherit të Kontratës;
 - Mbikqyrësit të Menaxherit të Kontratës;
 - Zyrës së Kryetarit;
 - Zyrës së Prokurimit.



Kryetar i Komunës

Agim Aliu



REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVA • REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E FERIZAJT • OPŠTINA UROŠEVAC • MUNICIPALITY OF FERIZAJ

<http://kk.rks-gov.net/ferizaj>



ZYRA E PROKURIMIT
KANCELARIJA ZA JAVNE NABAVKE
PROCUREMENT OFFICE

01. Nr. 287/2025

Datë: 01.10.2025

Tel.: 038.200.46.045

E- mail: prokurimi.ferizaj@rks-gov.net

Adresa: Dëshmorët e Kombit p.n.

Në bazë të nenit 81 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Lgjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092, si dhe nenit 70 të Rregullores Nr. 002/2024 për Prokurimin Publik, e datës 11.11.2024, Kryetari i Komunës merr:

V E N D I M

PËR EMËRIMIN E MENAXHERIT TË KONTRATËS DHE MBIKQYRËSIT TË DREJTPËRDREJTË TË MENAXHERIT TË KONTRATËS

1. Emërohet Menaxheri i kontratës dhe Mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë i Kontratës për kontratën: **“Rregullimi i oborreve të shkollave dhe drenazhimi i jashtëm”**, me numër të prokurimit: **656-25-7208-2-1-1**
2. **Emërohet Menaxher i kontratës:** z.Bashkim Bytyçi – zyrtar i lartë për arsimin e mesëm të ulët.
3. **Emërohet Mbikëqyrës i drejtpërdrejtë i Menaxherit të Kontratës:** znj.Mukadeze Sylejmani – zyrtare financiare ne drejtorinë e Arsimit.
4. Menaxheri i kontratës, dhe Mbikëqyrës i drejtpërdrejtë i Menaxherit të Kontratës obligohen që të bëjnë administrimin dhe menaxhimin e implementimit të kontratave në pajtim me Rregulloren Nr. 002/2024 për Prokurimin Publik, e datës 11.11.2024, për Prokurimin Publik, si dhe Manualet për Përdorim të Modulit për Menaxhim të Kontratës;
5. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.
T'u dorëzohet:

1. Menaxherit të Kontratës;
2. Mbikqyrësit të Menaxherit të Kontratës;
3. Zyrës së Kryetarit;
4. Zyrës së Prokurimit.



Kryetari i Komunës

Agim Aliu

Deklaratë e garantuesit

GARANCI KONTRATE
POLICA NR. 070070030008511

Për: KOMUNA FERIZAJ
(në vazhdim: "autoriteti kontraktues")

Në emër të: EUROLINDI SHPK
(në vazhdim "tenderuesi")

Titulli i prokurimit: Rregullimi i oborreve te shkollave dhe drenazhimi i jashtem

Numri i Prokurimit: 656-25-7208-2-1-1

Garancion me kërkesë te pare

DERISA operatori ekonomik i lartcekur, ka ndërmarrë veprimet për të dorëzuar një siguri të ekzekutimit duke iu referuar Dosjes së Tenderit, me numër të prokurimit të lartcekur të dërguar nga Autoriteti Kontraktues.

DHE NGASE operatori ekonomik dëshiron të depozitoi sigurinë në shumën e saktësuar në Dosjen e Tenderit

DHE NGASE jemi pajtuar t'i japim Operatorit Ekonomik këtë siguri:

ANDAJ NE të poshtë nënshkruarit, me këtë konfirmojmë se jemi Garantues dhe përgjegjës para jush, në emër të Operatorit Ekonomik, deri në një shumë totale prej 155,000.00 € Nje qinde e Pesedhjetë e Pes mije Euro zotohemi të ju paguajmë, që me kërkesën tuaj të parë me shkrim në të cilën deklarohet mospërmbushja e njërit nga kushtet në vijim :

- Autoriteti kontraktues ka konstatuar në bazë të dëshmive të vërtetueshme objektivisht se Operatori Ekonomik ka dështuar që të ekzekutoi kontratën e nënshkruar dhe kjo i ka shkaktuar autoritetit kontraktues dëme substanciale dhe/ose shpenzime të mëdha për mbylljen e kontratës në fjalë; dhe
- Operatori Ekonomik ka dështuar që të ekzekutoi kontratën e nënshkruar, dhe si rezultat i sajë kanë mbet pa u paguar shumë punëtor, nënkontraktor dhe / ose furnizues të materialeve.

Pagesa në shumën e limituar prej 155,000.00 € siç është thënë më lart, do të bëhet pa asnjë kundërshtim as ankesë, sa ma shpejtë që është e mundur pas regjistrimit të kërkesës suaj me konfirmimin "e pranimit".

Kjo siguri vlen deri me datën 31.10.2028



Nënshkrimi dhe vula e garantuesit
Kompania e Sigurimeve "SIGURIA"
Emri i institucionit financiar

Adresa: Rr. Qamil Hoxha, nr.51, Prishtinë

Data: 01.10.2025

PARAMASA KOMPLET

PROJEKTI: DRENIMI DHE MIRËMBAJTJA E JASHTME E OBJEKTEVE PUBLIKE –

PUNËT NDËRTIMORE DHE FURNIZUESE					
A					
Nr	Përshkrimi i punimeve	Njësia	Sasia	Çmimi	Totali
1	Pastrimi komplet i terenit, largimi i gjësendeve ekzistuese që bëjnë pengimin e mbarëvajtjes së punimeve si psh: shkurreve, rrethojave të vjetra etj. në konsultim me menaxherin e projektit.	m ²	1	12	12
2	Demolimi dhe bartja e materialit të objektit të vjetër ekzistues deri në deponi të caktuar, aty ku e cakton organi mbikqyrës (duhet të bëhet vizita në teren).	m ³	1	25	25
3	Demolimi dhe largimi i shtresës së betonit ekzistues që bëjnë pengimin e mbarëvajtjes së punimeve apo arsyeve tjera në konsultim me menaxherin e projektit.	m ³	1	15	15
4	Demontimi dhe zhvendosja e kubëzave të vjetra ekzistuese, duke i mbrojtur pa i dëmtuar. Të bëhet magazinimi i tyre i përkohshëm me qëllim të ripërdorimit të tyre.	m ²	1	12	12
5	Hedja e humusit me makineri të rëndë me trashësi sipas nevojës që paraqitet në teren dhe largimi i kësaj shtrese 5 km nga vendpunishja në konsultim me menaxherin e projektit.	m ²	1	10	10
6	Gërmimi i dheut me makineri të rëndë me trashësi sipas nevojës që paraqitet në teren dhe largimi i dheut të gërmuar 5 km nga vendpunishja në konsultim me menaxherin e projektit.	m ³	1	12	12
7	Furnizimi, transporti, planifikimi dhe kompaktimi i shtresës së tamponit me material të granulluar 0 - 6 mm me trashësi d = 25 cm në shtresa t = 15 cm me saktësi deri në ± 3 cm.	m ³	1	25	25
8	Ngjeshja e shtresës së tamponit me material të granulluar 0 - 50 mm, me mjete mekanike deri në arritjen e modulit të ngjeshjes My = 60 Mpa. Kontrolli i modulit të ngjeshjes sipas provës me pllakë rrethore me diametër 30 cm. Testimi bëhet me material me lagështi optimale. Standardi i aplikueshëm, DIN 18134.	m ³	1	8	8
9	Furnizimi, transporti, planifikimi dhe kompaktimi i shtresës së tamponit të granulluar 0 - 30 mm me trashësi d = 20 cm në shtresa t = 10 cm me saktësi deri në ± 3 cm mbi shtresën e parë.	m ³	1	28	28
10	Ngjeshja e shtresës së tamponit me material 0 - 30 mm me mjete mekanike deri në arritjen e modulit të ngjeshjes Mv = 70 Mpa. Kontrolli i modulit të ngjeshjes sipas provës me pllakë rrethore me diametër 30 cm. Testimi të bëhet me material me lagështi optimale. Standardi i aplikueshëm, DIN 18134.	m ²	1	6	6
11	Furnizimi dhe shtrirja e shtresës së rrës së imët me trashësi t = 5.0 cm si dhe nivelizimi dhe ngjeshja e tij mbi dy pozicionet e përshkruara më lart.	m ²	1	10	10
12	Furnizimi dhe montimi i kubëzave të betonit me trashësi t = 6 cm. Ngjyra, përmasat dhe dizajni, të përcaktohen sipas organit mbikqyrës. Paraprakisht të bëhet shtruarja e rrës së imët t = 5.0 cm si dhe ngjeshja e tyre mbi dy pozicionet e përshkruara më lart.	m ²	1	25	25
13	Furnizimi dhe montimi i kubëzave të betonit me trashësi t = 8 cm. Ngjyra, përmasat dhe dizajni, të përcaktohen sipas organit mbikqyrës. Paraprakisht të bëhet shtruarja e rrës së imët t = 5.0 cm si dhe ngjeshja e tyre mbi dy pozicionet e përshkruara më lart.	m ²	1	32	32
14	Montimi i kubëzave të betonit. Paraprakisht të bëhet shtruarja e rrës së imët me trashësi t = 5.0 cm si dhe ngjeshja e tyre mbi dy pozicione të përshkruara më lart.	m ²	1	8	8
15	Riparimi i shkallëve të dëmtuara në hyrje të objekteve publike. Këtu përfshihet, furnizimi dhe montimi me pllaka graniti ose me teraser dhe material lidhës deri në përfundim. Ngjyra, përmasat dhe dizajni, të përcaktohen sipas organit mbikqyrës.	m ²	1	45	45
16	Ngjeshja e shtresës së kubëzave me makineri adekuate, deri në nivelin e kënaqshëm, si dhe sigurimi, furnizimi dhe shtrirja (hedhja) e rrës së imët mbi shtresën e kubëzave të betonit.	m ²	1	8	8
16	Furnizimi dhe vendosja e gurëve skajor me dimensione b/h=18/24/80 cm dhe klasë të betonit C30/37 të vendosur në shtresë betoni C20/25 (vendosja sipas detaleve të dhëna në projekt dhe në përputhje me standardet EN 1340).	m ³	1	32	32

17	Furnizimi dhe vendosja e gurëve skajor me dimensione b/h=10/20/100 cm dhe klasë të betonit C30/37 të vendosur në shtresë betoni C20/25 (vendosja sipas detaleve të dhëna në projekt dhe në përputhje me standardet EN 1340).	m ³	1	26	26
18	Furnizimi dhe vendosja e gurëve skajor me dimensione b/h=08/20/100 cm dhe klasë të betonit C30/37 të vendosur në shtresë betoni C20/25 (vendosja sipas detaleve të dhëna në projekt dhe në përputhje me standardet EN 1340).	m ³	1	25	25
19	Furnizimi me material dhe punimi i hidroizolimit në muret e bodrumit dhe suteranit me një lyerje me bitulit dhe ngjitje me flakë të kondorit me trashësi t = 5 mm (një shtresë), por paraprkishtë të bëhet pastrimi i mureve, kurse kalimi i shtresave është 10 cm.	m ²	1	18	18
20	Furnizimi me material dhe vendosja e PVC-së, folisë për mbrojtje të hidroizolimit në muret e bodrumit e cila është konstruktuar të jetë edhe filtruese dhe barierë e avullit,	m ²	1	10	10
21	Furnizimi dhe vendosja e zhavorit 0.40 mm të drenazhimit mbas vendosjes së folisë mbrojtëse nga materiali i PVC-së.	m ³	1	28	28
22	Furnizimi dhe shtrirja e gypit të drenazhimit nga materiali i PVC-së, me dim. Ø 160 mm.	m ³	1	15	15
23	Furnizimi dhe shtrirja e gypit të drenazhimit nga materiali i brinjëzuar, me dim. Ø 110 mm.	m ³	1	12	12
24	Sigurimi, furnizimi dhe montimi i elementeve të pusetave DN-800 mm (gypat e betonit).	copë	1	85	85
25	Sigurimi, furnizimi dhe montimi i elementeve të pusetave DN-800 mm (konuset prej betonit).	copë	1	75	75
26	Ndërtimi i fundit të pusetës prej betoni MB-20 trashësi 20 cm dhe ndërtimi i kinetës së pusetës duke i dhënë rënien e duhur dhe lëmuarjen e saj deri në shkëlqim.	copë	1	65	65
27	Furnizimi me material si dhe punimi i sipërfaqeve gjelbëruese. Pozicioni përfshinë këto aktivitete: Furnizimin me dhëra cilësore për mbjelljen e barit ku trashësia e shtresës duhet të jetë 15 cm. Shpërndarja e dheut dhe përgaditja për mbjelljen e barit.	m ²	1	22	22
28	Sigurimi, furnizimi dhe bjellja e barit cilësor, mirëmbajtja e sipërfaqeve gjelbëruese derinë kositjen e parë të barit.	m ²	1	17	17
29	Sigurimi, transportimi dhe bjellja e fidaneve me gjatësi 1.70 – 1.80 m të llojeve të ndryshme: PAULOWNIA, ELONGATE, CATALPA, PRUNUS PISARDI, AESCULES, HIPPOCASTANUM, ACER PLAT DRUMMONDI etj. Mirëmbajtja të jetë 6 muaj. Llogaria për copë.	copë	1	150	150
30	Furnizimi dhe shtrirja e betonit përreth objektit në trotuar me gjërësi d = 1.20 m me trashësi h = 10 cm me rrjetë të armaturës Ø8 me katror 15 x 15 cm. Gjithashtu, duhet të bëhet ndarja në çdo një metër dhe para shtrimit duhet të shtrohet tamponi i zhavorit 0 - 60 me trashësi d = 20 cm i cili ngjeshet me mjete mekanike deri në modulën MV = 70 MPa.	m ²	1	25	25
31	Riparimi i shkallëve të dëmtuara në hyrje të objekteve publike. Këtu përfshihet furnizimi dhe montimi me pllaka graniti ose me teraser dhe material lidhës deri në përfundim. Ngjyra, përmasat dhe dizajni, të përcaktohen sipas organit mbikëqyrës.	m ²	1	45	45
Totali 1: Pesha 75 %					931
B NDËRTIMI I MURIT MBROJTËS					
1	Gërmimi i kanalit dhe vendi ku vendoset muri mbrojtës, aty ku parashihet në konsultim me menaxherin e projektit.	m ²	1	15	15
2	Thyerja me çekan e pjesëve të betonit të armuar ekzistues.	m ²	1	25	25
3	Furnizimi, transporti dhe punimi i armaturës për muret mbrojtëse në konsultim me menaxherin e projektit.	kg	1	2.8	2.8
4	Furnizimi, transporti dhe hedhja e betonit të markës C 30/37 në muret mbrojtëse në konsultim me menaxherin e projektit.	m ³	1	160	160
5	Sigurimi, furnizimi, bartja, shtrirja dhe ngjeshja e asfaltbetonit të granuluar 0/16 mm, me trashësi të shtresës t = 7 cm.	m ²	1	35	35
Totali 2: Pesha 5 %					237.8
PUNËT E KANALIZIMIT ATMOSFERIK					
C (Për objektet publike)					
1	Gërmimi i kanalit në kat. III-IV të dheut, me makineri në gjërësi sipas normave dhe standardeve teknike (varësisht nga diametri i gypit) me thellësi mesatare 1.5 m'. Llogaria për metër kub (m ³).	m ³	1	10	10

2	Planifikimi i fundit të kanalit me dorë me saktësi ± 1 cm.	m ²	1	5	5
3	Furnizimi, transporti dhe vendosja e rërës 0 - 4 mm në fundin e kanalit anash dhe mbi gypa.	m ³	1	25	25
4	Mbulimi planifikimi i kanalit me material tampon zhavor 0 - 31,5 mm me ngjeshje në shtresa 25 - 30 cm.	m ³	1	22	22
5	Transporti i materialit të tepërt deri në deponinë ilegale të përcaktuar me ndihmën e investitorit, jo më larg se 10 km.	m ³	1	10	10
6	Furnizimi, transporti dhe montimi i tubave të brinjëzuar PE SN4 Ø 200 mm sipas standardeve.	m'	1	15	15
7	Furnizimi, transporti dhe vendosja e betonit për pllakën e poshtme për puseta me betonarme C - 20/25 d = 20 cm.	m ³	1	25	25
8	Furnizimi, transporti dhe montimi i tubave (për puseta) prej betoni të armuar Ø 800/1000 mm me mbarim konus (elemente të parafabrikuara) të cilat duhet të vendosen në bazë betoni d = 20 cm si dhe punimi i kinetës të cilat janë pjesë e këtij pozicioni. Llogaria për copë.	copë	1	75	75
9	Prerja e asfaltit me makinë sipas nevojës. Këtu përfshihet edhe prerja e asfaltit në vendet ku do të vendosen kapakët e teleskopikut dhe hidrantit.	m ²	1	10	10
10	Kthimi i asfaltit në gjendjen fillestare 7 cm, me gjërësi b = 0,70 m. Këtu përfshihet edhe asfaltimi në vendet ku do të vendosen kapakët e teleskopikut dhe hidrantit.	m ²	1	35	35
11	Kalimi i rrugës së asfaltuar me shpim me gypa të çelikut D225 mm për vendosjen e gypave të kanalizimit të brinjëzuar me dim. Ø - 160 mm. Vërejtje: Ky pozicion duhet të kryhet patjetër me shpim të shkollat në qytet ku nuk lejohet të pritët apo dëmtohet asfalti.	m'	1	45	45
12	Furnizimi, transporti dhe montimi i kapakëve prej materialit kompozit, me aftësi mbajtëse 25 t deri 40 t. Në qimim të llogaritët edhe betonimi i kurorës prej betonarmesë C-20/25.	copë	1	120	120
Totali 3: Pesha 5 %					397

D	PUNËT E UJËSJELLËSIT (për objektet publike)				
1	Gërmimi i dheut të kategorisë së III dhe IV me makinë dhe dorë, me gjërësi b = 0.60 m dhe thellësi mesatare h = 1.10 m	m ³	1	1	1
1.1.1	- Me makinë 90%	m ³	1	10	10
1.1.2	- Me dorë 10 %	m ³	1	15	15
1.2	Furnizimi dhe hedhja e rërës nën, mbi dhe anash gypit me planifikim dhe ngjeshje.	m ³	1	25	25
1.3	Mbulimi i gjithë kanalit me dheun e gërmuar duke bërë ngjeshjen në shtresa 20 - 30 cm.	m ³	1	8	8
1.4	Largimi i dheut të tepërt në vendin ku e cakton organi mbikqyrës.	m ²	1	10	10
1.5	Prerja e asfaltit me makinë sipas nevojës. Këtu përfshihet edhe prerja e asfaltit në vendet ku do të vendosen kapakët e teleskopikut dhe hidrantit.	m ²	1	5	5
1.6	Kthimi i asfaltit në gjendjen fillestare 7 cm, me gjërësi b = 0.70 m. Këtu përfshihet edhe asfaltimi në vendet ku do të vendosen kapakët e teleskopikut dhe hidrantit.	m ²	1	35	35
1.7	Kalimi i rrugës së asfaltuar me shpim me gypa të çelikut D150 mm për vendosjen e gypave të ujit Ø - 110 mm. Vërejtje: Ky pozicion duhet patjetër të kryhet me shpim të shkollat në qytet ku nuk lejohet të pritët apo të dëmtohet asfalti.	m	1	10	10
2	Punët montuese				
2.1	Furnizimi, instalimi dhe vënja në vepër e gypave HDPE 100 10 bar me saldim ballor.	m'	1	1	1
2.1.1	Ø -110 mm, PN-10.0 bar	m'	1	10	10
2.1.2	Ø -63 mm PN-10.0 bar	m'	1	8	8
2.1.3	Ø -32 mm, PN-10.0 bar	m'	1	7	7
2.1.4	Ø -25 mm, PN-10.0 bar	m'	1	6	6
3	Sigurimi dhe montimi i qaforeve me kthesë dhe gjysëmlihdhëse nga PF për realizimin e kyqeve (për objektet publike).	copë	1	1	1
3.1.1	Ø -110/63 mm, PN - 10.0 bar	copë	1	25	25
3.1.2	Ø -63/32 mm, PN - 10.0 bar	copë	1	25	25
4	Montimi i ujëmatësit dhe dy holanderëve të ujëmatësit (pjesë përcjellëse) DN - 32 mm, PN - 10.0 bar	copë	1	5	5
5	DN - 32 mm, PN - 10.0 bar	copë	1	5	5

6	Sigurimi, furnizimi dhe montimi i pusëtës me dimensione të brendshme min.80 cm, si dhe kapaku i saj.	copë	1	120	120
7	Sigurimi, furnizimi dhe montimi i pjesëve të nevojshme për lidhjen e kycjes së re me gypin e kycjes ekzistuese. Në çmim të përfshihen furnizimi, transporti dhe puna e të gjitha pjesëve që nevojiten, varësisht prej materialit të gypave të kycjeve ekzistuese, për ta relizuar këtë lidhje. Çmimi të jepet komplet për çdo kycje.	copë	1	25	25
Total 5: Peshë 5 %					357
E	UJITJA				
1	Punët për ndërtimin e pusit				
1.1	Hapja e pusit me makineri dhe ndërtimi i tij me tub betoni Ø1000 mm, deri në thellësi 20 m. Në çmim përfshihet hapja dhe vendosja e tubave të betonit në hapje	m'	1	150.00 €	150.00 €
1.2	Pastrimi i terenit menjëherë gjatë hapjes së pusit dhe largimi i dheut deri në deponi deri në 5 km distancë.	m³	1	25.00 €	25.00 €
1.3	Furnizimi dhe vendosja e zhavorit të lumit rreth pusit.	m³	1	50.00 €	50.00 €
1.4	Pastrimi i pusit me anë të pompës deri në largimin e sendimenteve dhe vajrave të mbetura nga shpimi.	Komplet	1	150.00 €	150.00 €
1.5	Furnizimi, transporti dhe montimi i materialit për realizimin e pusëtës eksploatuese afër pusit. Në çmim përfshihen të gjitha punët e betonit, armes, pjesët fazonike, ena ekspanduese, kablo, sipas përshkrimit teknik dhe vizatimeve në projekt.	Komplet	1	100.00 €	100.00 €
1.6	Testimi i pusit me tri ulje të nivelit në pus pa ndërprerje në kohëzgjatje prej 48 orë me përcjellje permanente të oscilimit të nivelit të ujit në pus	Komplet	1	100.00 €	100.00 €
2	Punët montuese				
2.1	Furnizimi, transporti dhe montimi i elektro valvulave zonale me rregullator të fluksit duke përfshirë rregullatorin e presionit. Gama e funksionimit prej 1.0 deri 10.3 bar, prurje 4.17 deri 125 l/min.	copë	1	220.00 €	220.00 €
2.2	Furnizimi, transporti dhe montimi i panelit të kontrollit kryesor, paneli me kontroll qendror IQ4, sistem me 2 tela (2-Wire). Kontrolluesi qendror duhet të mbështet 240 stacione, 40 programe, 10 sensorë rrjedhjeje dhe 8 sensorë moti. Koha e stacionit 0 min deri 96 orë, niveli i programimit global mujor sezonal.	copë	1	220.00 €	220.00 €
2.3	Blerja dhe montimi i sensorit për shi në mënyrë automatike për ndërprerje të ujitjes	copë	1	100.00 €	100.00 €
2.4	Furnizimi transporti dhe montimi i tubit XFS me vrima Ø16mm, distanca ne mes emituesve duhet te jetë 61cm, norma e emituesit 3.4 liter për orë. Sipas përshkrimit teknik dhe vizatimeve në projekt.	m	1	8.00 €	8.00 €
3	Furnizimi, transporti dhe montimi i tubave të furnizimit me ujë për përdorim nëntokë, HDPE 100, për ujitje. Në çmim llogariten edhe lidhëset, kthesat, T pjesët, për realizimin e rrjetit shpërndarës si dhe realizimin e kolektorëve në hyrje dhe dalje të zonave ujitëse me sistem pika - pika.				
3.1	HDPE 100; PN-16 bar; Ø20	m	1	10.00 €	10.00 €
3.2	HDPE 100; PN-16 bar; Ø25	m	1	8.00 €	8.00 €
3.3	Furnizimi transporti dhe montimi i pompës zhytëse për ujitje nga pusi. Pompa duhet të jetë nga materiali i çelikut inox AISI 304 sipas EN 1430, diametri i pompës duhet të jetë 74mm me madhësi të lidhjes DN32, fuqia e pompës 1.55 KW, pompa me kapacitet Q = 0.5 l/s dhe lartësi dërgimi 60 m. Në çmim përfshihen valvolat njëkahore, zinxhiri për tërheqje të pompës.	copë	1	1,250.00 €	1,250.00 €
3.4	Testimi i rrjetit dhe pastrimi , sipas përshkrimit teknik.	Komplet	1	20.00 €	20.00 €
Total 5: Peshë 10 %					2,411.00 €
Nr	Përshkrimi	Çmimi i peshuar	Peshë	Çmimi i peshuar	
A	Totali 1	931	75%	698.25	
B	Totali 2	237.8	5%	11.89	
C	Totali 3	397	5%	19.85	
D	Totali 4	357	5%	17.85	
E	Totali 5	2,411.00 €	10%	241.1	
TOTALI		4333.8	100%	988.94	

Romigian vlersues:

1. H. Krasniqi
2. S. H. Krasniqi
3. J. Krasniqi

